

**Gjuhë shqipe dhe letërsi**  
**5 orë në javë; 185 orë në vit**  
**80 letërsi shqipe; 72 letërsi e huaj; 33 gjuhë**

**PROGRAMI PËR KLASËN E NJËMBËDHJETË**

**(Gjimnazi i Gjuhëve)**

**Hyrje**

Programi i klasës së njëmbëdhjetë është pjesë e programit të shkollës së mesme të lartë. Në këtë nivel zhvillohet puna e pavarur e nxënësit dhe kultivimi i mendimit kritik. Kërkesat themelore për këtë klasë kanë të bëjnë me formimin e mëtejshme kulturor, letrar e gjuhësor, me përvetësimin e dijeve dhe formimin e personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit.

Në këtë klasë duhet të zotërohen njohuritë gramatikore të fituara në klasët e mëparshme, të mënjanoen dobësitë morfosintaksore dhe drejtshkrimore që pengojnë përdorimin korrekt të gjuhës, të detajeve dhe të strukturave më të përgjithshme e komplekse, duke filluar nga fjalia e deri te teksti. Duhet të njihen dukuritë që nuk janë njohur dhe të zgjerohen e të përforcohen njohuritë që nuk janë thelluar në shkollën e mesme të ulët dhe në klasën e mëparme. Po kështu duhet të njihen dhe të përforcohen lidhjet ndërmjet gramatikës, analizës së teksteve, praktikave gojore dhe punëve me shkrim të tipeve të ndryshme; të përforcohen njohuritë për njësitë themelore të gjuhës dhe lidhjet e tyre, nga fonema tek fjala, nga fjala tek fjalia, nga fjalia e thjeshtë tek fjalia e përbërë ndryshe nga ç'janë zhvilluar në shkollën e mesme të ulët. Po kështu duhet të zhvillohet edhe puna me drejtshkrimin.

Në të njëjtën kohë, do të gjejë vend edhe aplikimi i dijeve të përvetësuara nga letërsia, kultura e gjuha, nëpërmjet formave të ndryshme të krijimtarisë; të eseve, punimeve të ndryshme shkollore etj. Kjo do të ndihmojë strukturimin e mendimeve, gjykimeve e imagjinatës së nxënësve, që të jenë në gjendje që t'i trajtojnë me gojë e me shkrim problemet nga këndvështrime të ndryshme kulturore, letrare, gjuhësore e kritike. Të gjitha këto do të ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e mirëfilltë kulturor, letrar e gjuhësor të nxënësit.

Rritja e shkallës së zotërimit të gjuhës amtare dhe formimi letrar e kulturor i nxënësit, janë ndër synimet themelore për këtë klasë. Kjo pritet të realizohet përmjet shkathtësive të komunikimit, leximit, analizës e vlerësimit të llojeve të ndryshme të teksteve, letrare e joletrare etj.

## Qëllimet

Qëllimi i mësimi të kësaj lënde në klasën e njëmbëdhjetë është që nxënësi:

- të përforcojë të arriturat nga klasat e mëparme dhe të zhvillojë më shumë shkathtësitë e të dëgjuarit dhe të folurit, të leximit dhe të shkrimit;
- të rrisë aftësinë për analizë kritike të teksteve dhe fenomeneve kulturore;
- të rrisë nivelin e komunikimit me tekste letrare e joletrare;
- të rrisë aftësinë e komunikimit me modele e kultura të ndryshme etj.;

## Objektivat

### Të njohë

- kulturën dhe autorët e fundit të Mesjetës, të Rilindjes dhe të Klasicizmit;
- romantizmin evropian dhe letërsinë e Rilindjes Kombëtare

### Të kuptojë

- rëndësinë e kulturave të ndryshme për zhvillimin e kulturës dhe të letërsisë shqipe;
- esencat kulturore, letrare e gjuhësore që do të ndihmonin zhvillimin e mendimit individual;
- kulturën , letërsinë nacionale dhe atë të huaj.

### Të analizojë

- tekste të ndryshme për nga qëllimi, struktura, përmbajtja, detajet dhe efektet;
- tekste letrare dhe joletrare, nga autorë të periudhës së Rilindjes Kombëtare

### Të vlerësojë

- tekste e modele kulturore e letrare;
- autorë e tekste të ndryshme letrare;
- krijimet të autorëve të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj, kryesisht të periudhës romantike.

Realizimi i këtyre objektivave nënkupton zhvillimin e këtyre **kategorive** (shkathtësive të komunikimit):

- **TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT**
- **LEXIMI**
- **SHKRIMI**

Ndërsa, **nënkategoritë** përkatëse janë:

- Modelet kulturore
- Tekstet letrare dhe joletrare
- Kulturë gjuhe
- Letërsia shqipe dhe e huaj
- Kulturë komunikimi

## **Përmbajtja**

### **Fushat tematike**

- Kohërat Moderne/Kulturat/Poetikat
- Modelet kulturore
- Tekstet letrare dhe joletrare
- Kulturë gjuhe
- Fundi i Mesjetës, Rilindja dhe Neoklasicismi
- Letërsia dhe Shoqëria
- Letërsia/Idetë/Kultura
- Letërsia/Identiteti/Nacionalizmi kulturor
- Rilindja Kombëtare Shqiptare

### **Kohërat Moderne**

Hetohet konteksti i letërsive dhe kulturave brenda Kohërave Moderne, prej fillimit të Rilindjes e deri në fund të Romantizmit, dhe jepen tiparet e Kulturave dhe Poetikave përkatëse; teksteve dhe konteksteve.

### **Modelet kulturore**

Jepen tiparet kryesore të modeleve të ndryshme kulturore që lidhen me fundin e Mesjetës, Rilindjen, Klasicismin, Romantizmin dhe Sentimentalizmin.

## **Tekstet letrare dhe joletrare**

Jepen tekste letrare e joletrare nga kultura dhe letërsia shqiptare dhe ajo e huaj; në funksion të dijeve kulturore e letrare, duke njohur edhe autorë të caktuar, forma të shkrimeve e të komunikimeve kulturore.

## **Fundi i Mesjetës, Rilindja dhe Neoklasicizmi**

Jepen tiparet e këtyre epokave/formacioneve pastaj ilustrohen me autorë dhe tekste të zgjedhura të tyre.

### **Tipare të Rilindjes evropiane**

- F. Petrarka  
*Libri i këngëve*; struktura e librit; struktura e sonetit; struktura e vargut; struktura tematike  
Tekste të zgjedhura për analizë dhe komente
- Gj. Bokaço  
*Dekameroni*; struktura e novelës; rrëfimi; personazhi  
Novelë e zgjedhur për koment
- M. Servantesi  
*Don Kishoti i Mançës*; veçori të romanit; romani i Servantesit dhe romani kalorsiak; personazhi; diskursi  
Fragmente për të ilustruar
- U. Shekspiri  
Teatri elizabetian  
Tragjedia - struktura, modeli i personazhit, tragjikja  
Komedia - struktura, situatat, diskurset  
*Hamleti*  
*Shumë zhurmë për asgjë*  
Fragmente të zgjedhura për të ilustruar

### **Tiparet e neoklasicizmit**

- Zh. Rasini  
Struktura e tragjedisë neoklasike. Raportet me tragjedinë klasik. Temat dhe idetë  
*Fedra*  
Përpunohet një skenë e zgjedhur
- Moliere  
Esenca e komedisë neoklasike. Temat, personazhet, diskursi  
*Kopraci*  
Skenë e zgjedhur për analizë dhe ilustrime

## **Romantizmi evropian dhe letërsia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare**

Jepen tiparet e romantizmit evropian dhe të Rilindjes Shqiptare, pastaj autorët dhe shembujt e zgjedhur:

#### **a. Romantizmi evropian**

- V. Gëte  
Pararomantizmi dhe romantizmi  
*Fausti* - struktura, tema, situatat themelore, personazhet  
Fragmente për ilustrime dhe komentime
- V. Ygo  
Poezia - diskutet poetike; poema  
Esencat romantike  
Tekste të zgjedhura për t'u përpunuar
- Xh. Bajron  
*Shtegtimet e Çajlld Haroldit* - struktura e poemës, esenca romantike, diskursi personal  
Përpunohet së paku një këngë

#### **b. Letërsia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare**

- J. De Rada dhe autorë të tjerë arbëreshë  
*Milosaos*: shkrimi personal; struktura e *Milosaos*; personazhet  
*Skandebeku i pafan* dhe poema të tjera - informacione: temat dhe diskutet

Gavril Dara i Riu

*Kënga e sprasme e Balës*: struktura, tema, situatat themelore, personazhet

- K. Kristoforidhi  
Përkthimet - të dhëna  
Tregimi; variantet tekstore-gjuhësore, tema, simbolika
- N. Frashëri  
Lirika: temat, diskutet  
Poemat: *Istori e Skënderbeut*, *Qerbelaja*, *Bagëti e Bujqësia*  
Tekstet praktike  
Temat dhe diskutet  
Heroi nacional. Heroi moral  
Ilustrime me këngë të zgjedhura

- Z. Serembe

Lirika: temat dhe diskurset personale  
Strukturat metrike dhe stilistike

- Z. Skiroi

Poema: llojet, strukturat, temat, diskurset

*Mili e Hajdhia*

*Te dheu i huaj*

Pjesë të zgjedhura për ilustrime dhe komentime

- S. Frashëri

Shqipëria në tri kohë

Modeli social dhe politik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Përpunohen pjesë të zgjedhura nga *Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhet*

Krahasim i autorëve shqiptarë me ata evropianë. Poetikën e tyre/ afritë dhe dallimet.

Nëpërmjet autorëve ilustrohen edhe të gjitha fushat e tjera tematike, idetë, heronjtë e nocionet që dalin në përmbajtjen e tekstit të klasës së njëmbëdhjetë.

Për çështje të caktuara shihen edhe autorë të tjerë botërorë dhe shqiptarë - me zgjedhje.

### **Letërsia dhe Shoqëria**

Në shembuj të zgjedhur hetohen relacionet letërsia/shoqëria, përkatësisht letërsia/politika. Analizohen raportet e letërsisë shqipe me funksionet joletrare/politike dhe misionare.

### **Letërsia / Idetë / Kultura**

Letërsia vihet në raport me idetë gjatë periudhave të ndryshme kohore, veçan gjatë Rilindjes Kombëtare, duke e parë edhe sfondin kulturor.

### **Letërsia / Identiteti / Nacionalizmi kulturor**

Shihet dhe analizohet raporti i letërsisë shqipe dhe asaj të huaj me tiparet e identitetit: personalja/nacionalja, dhe pastaj edhe letërsia si pjesë e projekteve që lidhen me nacionalizmin kulturor të shek. XIX, veçan atij gjerman.

### **Rilindja Kombëtare Shqiptare**

Veçohen karakteristikat themelore të projektit nacional shqiptar të quajtur *Rilindja Kombëtare* dhe identifikohet statusi i letërsisë shqipe brenda këtij projekti.

### **Kulturë gjuhe**

Puna me gjuhën do të përqëndrohet në aspektin kuptimor dhe ka si synime themelore:

- studimin e variacioneve historike, shoqërore dhe kulturore të përdorimit të gjuhës;
- njohjen e veçorive gjuhësore që lidhen me fjalinë, tekstin dhe ligjërimin;
- përmirësimin e strukturës dhe të koherencës së teksteve të paraqitura nga nxënësit;
- pasurimin e fjalorit, sidomos të atij abstrakt dhe afektiv.
- raportet e gjuhës standarde me dialektet e shqipes dhe të zbatimit të normës së shqipes standarde në praktikën e gjuhës së folur dhe të shkruar,
- ligjërimin, format e ligjërimin, artin e të bindurit, tekstin, fjalinë etj., (njohja dhe zbatimi i drejtë në praktikën e gjuhës së folur dhe të shkruar);
- veçoritë e ndërtimit dhe të funksionimit të ligjëtimeve;
- veçoritë e funksionimit të tri niveleve gjuhësore;
- struktura dhe modalitetet e fjalisë së thjeshtë dhe të përbërë;
- lidhjet dhe marrëdhëniet sintaksore; vlerat modale dhe kohore të foljeve;
- njohjen dhe përdorimin i figurave të stilit; (zëvendësimi; kundërvënia; insistimi, smadhimi/zvogëlimi, analogjia);
- fjalët dhe raportet e tyre; raportet e identitetit dhe të kundërvënies së fjalëve (sinonimet dhe antonimet,
- vlera emocionale e fjalëve në një tekst letrar (konotacionet); tërësia e fjalëve që shprehin të njëjtin realitet mbrenda një teksti (fusha leksikore);
- modelet a mënyrat e të shkruari, (veçoritë e një shkrimi letrar) lindja e projektit, hartimi i planit, shkrimi i veprës, njohja dhe praktikimi i modeleve dhe mënyrave të shkrimit: eseja;

- metodologji e punës së pavarur, përgatitja e një punimi dhe njohja e kërkimeve dokumentare;
- këshilla praktike për gjuhën e shkruar: shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. Mënjanimi i fjalëve të huaja të panevojshme.

Jepen tekste, ushtrime dhe detyra, duke nënkuptuar këtu edhe shkrimin e eseve, me qëllim zhvillimin e shkathtësive gjuhësore nga stilistika gjuhësore, gjuha standarde, gjuha dialektore etj. Jepen shembuj të dimensioneve stilistike të shqipes; sekuenca, stili, diskurset; gjuha kritike dhe ajo kreative.

## **Rezultatet e pritura**

Në fund të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi:

- zotëron shkathtësi të veçanta individuale, njohëse dhe komunikative, për punë individuale dhe në grupe;
- analizon, vlerëson, sintetizon dhe organizon informata nga burime të ndryshme, duke i shtruar ato në nivelin e pyetjeve, problemeve e çështjeve;
- njeh formacionet e ndryshme kulturore e letrare të Kohërave Moderne, nga Rilindja e deri te fillimet e Realizmit;
- identifikon, njeh dhe praktikon, nëpërmjet shkrimit, format e ndryshme letrare dhe joletrare;
- kupton format dhe idetë themelore të kulturës dhe letërsisë së fundit të Mesjetës, përkatësisht të fillimit të Rilindjes, për të vazhduar me njohjen e kulturës dhe letërsisë klasiciste e romantike, të huaj dhe shqiptare;
- kupton tiparet e letërsisë e kulturës shqiptare që lidhen me Rilindjen Kombëtare, si projekt nacional shqiptar;
- zotëron shkathtësitë argumentuese dhe vlerësuese për kulturën dhe për letërsinë, sikur edhe dijet gjuhësore, duke praktikuar lloje të ndryshme të analizave e të shkrimeve; veçanërisht në aspektin sintaksostilistik;

## **Qasjet ndërlëndore dhe ndërprogramore**

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. Megjithatë, lidhje të drejtëpërdrejta vehen me historinë, gjeografinë, edukatën qytetare, artet etj. Disa tema nga këto lëndë ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, në formimin kulturor dhe në krijimin e individualitetit të pavarur. Përveç çështjeve ndërlëndore si p.sh. tema për shëndetësi, për të drejtat e njeriut, për çështjet gjinore etj. Temat mund të zgjedhen nga mësimdhënësi, varësisht prej rëndësisë dhe aktualitetit që kanë (nga televizioni, revistat, gazetat apo nga ambienti i tyre).

## **Udhëzime metodologjike**

Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë metodat më bashkëkohor të mësimdhënies. Kjo hap rrugë për mësimin aplikativ. Mësimi duhet të organizohet në seanca që bashkojnë të folurit, shkrimin dhe leximin. Seanca ndryshon varësisht nga synimet e mësimdhënësit dhe të reagimeve të nxënësve.

Do të aplikohen dy mënyra leximi: leximi analitik dhe leximi i shpejtë. Leximi analitik ka si qëllim analiza të hollësishme të objektivave të caktuara dhe mund të aplikohet në tekste të gjatësive të ndryshme. Leximi i shpejtë nënkupton leximin e zakonshëm. Me të nxitet pavarësimi i nxënësve për leximin e teksteve të ndryshme. Raporti ndërmjet këtyre dy tipave të leximit duhet të jetë i ekuilibruar.

Lidhja ndërmjet leximit e shkrimit duhet të jetë e përhershme, qoftë edhe kur aplikohen shkrime kreative, imituese ose transformuese. Studimi aplikativ i gjuhës është një element i përbashkët i të gjitha aktiviteteve të parashtruara.

## **Vlerësimi**

Vlerësimi që duhet bërë gjatë klasës së njëmbëdhjetë dhe në fund të saj, lidhet me veprimtarinë dhe mjetet me të cilat gjykohen puna dhe arritjet e nxënësve për klasën përkatëse. Klasa e njëmbëdhjetë përfshihet në nivelin e shkollës së mesme të lartë dhe parimet, kushtet, metodat, teknikat dhe mjetet e vlerësimit, realizohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit për këtë nivel. Kjo nënkupton praktikimin e tipave të ndryshme të vlerësimit, varësisht nga nevoja dhe situata, siç janë: vlerësimi përcaktues, formues, diagnostikues, përmbledhës, individual, në grup, i brendshëm, i jashtëm etj.

## **Literatura:**

- Tekstet që hartohen mbi këto planprograme
- Tekste të mëhershme që përmbajnë këtë materie
- Eqrem Çabej: *Romantizmi në Europë Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare*
- Zejnullah Rrahmani: *Teoria e letërsisë (Për shkollat e mesme)*
- Tekste të tjera alternative